

RAPORT VJETOR 2010

**Përgatitur për Mbledhjen e Kuvendit të STIKK
Janar, 2011**

Permbajtja

1. Mbledhja vjetore e Kuvendit të STIKK.....	3
2. Aktivitetet sipas objektivave	5
2.1. Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK	5
2.1.1. Raporti i Hulumtimit të Sektorit të TIK në Kosovë 2009 dhe Raporti mbi doganat dhe TVSH e vendeve në rajon për sektorin e TIK.....	6
2.1.2. Trajnimi mbi Avokim dhe Lobim, Warshavë, Poloni	6
2.1.3. Prezantimi i parë publik i Rekomandimeve të STIKK lidhur me heqjen e doganës dhe zvogëlimin e TVSH për mallra dhe shërbime të TIK	6
2.1.4. Anëtarësimi në Këshillin Konsultativ të NVM.....	7
2.1.5. Takim me Departamentin e Politikave Ekonomike dhe Fiskale , Ministria e Ekonomisë dhe Financave 7	
2.1.6. Bashkepunimi me DFID /Fuqizimi i dialogut publiko-privat.....	7
2.1.7. E drejta pronësore intelektuale	8
2.1.8. Konferenca njëditore mbi BPO (Business Process Outsourcing)	8
2.1.9. Prezentimi publik i manualit të së drejtës pronësore intelektuale për zhvilluesit softuerik 9	
2.2. Objektivi 2. Rritja e imazhit pozitiv të industrisë së TIK-ut para sektorit publik dhe atij privat përmes implementimit të fushatave të marketingut	9
2.2.1. Panairi "Pristina ITTF Fair 2010"	9
2.2.2. STIKK sjell teknologjinë e fundit pranë fëmijëve	9
2.2.3. Përvjetori i dytë i STIKK	9
2.3. Objektivi 3. Ndhim në krijimin e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të shoqatës dhe mundësive biznesore jashtë Kosovës, përmes rrjetëzimit, ngjarjeve biznesore dhe integritit në iniciativat rajonale	10
2.3.1. Përfaqësimi i parë i Kosovës në CeBIT 2010	10
2.3.2. Takimi B2B për bizneset Kosovare dhe Maqedonase.....	10
2.3.3. Takimi rajonal B2B i kompanive të TIK	10
2.3.4. B2B midis kompanive të Kosovës dhe Shqipërisë dhe krijimi i rrjetit mbarëkombëtar të komunitetit të Teknologjisë së Informacionit	11
2.3.5. STIKK firmos Marrëveshje të Mirëkuptimit me OEK	11
2.3.6. Delegacioni Turk i IT viziton Kosovën	12
2.3.7. Seminari mbi E-Qeverisjen, Portorozh, Slloveni	12
2.3.8. Konferenca e 8-të e SEEITA-së, takimi i 7-të i forumit të TIK të Evropës Juglindore dhe konferenca e 7-të e ditëve të hapura të MASIT	12
2.3.9. Konferenca e TIK në Bullgari	13
2.4. Objektivi 4. Zhvillimi i sistemit të edukimit dhe të shkathtësive në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK (Work force Development)	13

2.4.1.	Trajnimi mbi CRM (Customer Relationship Management).....	13
2.4.2.	Skills Gap Analysis – Identifikimi i mungeses se shkathtesive ne sektorin e TIK.....	13
2.4.3.	Call Center Training – Trajnimi i agjenteve te Qendrave te thirrjes.....	14
2.4.4.	Trajnimi i Stafit te STIKK	14
2.4.5.	Seminar mbi e-Qeverisjen për komuna	14
2.5.	Objektivi 5. Sigurimi i qëndrueshmërisë së shoqatës.....	14
2.5.1.	Vizita në Oslo, Norvegji	14
2.5.2.	Reciklimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike	14
2.5.3.	Qendra e Inovacionit (Innovation center/Hub).....	15
2.5.4.	Vizita në Hagë, Holandë, 1-4 qershor, 2010.....	15
2.5.5.	Bashkepunimi me shoqaten e TIK të Hungarisë	15
2.5.6.	Mbeshtetja e STIKK per AITA (Albanian IT Association).....	15
2.5.7.	Projekti STIKK 2	15
2.5.8.	Anetaresimi	16
2.5.9.	Zhvillimi i Planit Strategjik 2011-2013.....	16
2.5.10.	Bashkëpunimi ndërmjet STIKK dhe IDC.....	16
3.	Donatoret	16
	Qeveria Norvegjeze	16
	Programi KPEP i USAID	16
	GTZ	17
4.	Stafi i STIKK	17
5.	Te hyrat dhe shpenzimet	18
6.	Mbledhjet e Bordit.....	0
7.	Permbyllje	2

RAPORT VJETOR 2010

PËRMBLEDHJE

Njëra nga aktivitetet e para të kësaj periudhe ka qenë organizimi i Kuvendit Vjetor të anëtarëve të STIKK, i cili u mbajt më 28 janar 2010, ne te cilin u aprovuan plani i punës dhe buxheti per vitin 2010, u votuan anëtarët e rinj te bordit dhe u aprovua skema e anëtarësisë.

Gjate periudhës njëvjeçare, një nga aktivitetet kryesore ka qenë angazhimi i shoqatës rreth realizimit te Objektivit te pare -**Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK**, e qe ka te beje me ndryshimit të Ligjit mbi TVSH dhe Doganat për importin e pajisjeve të IT, e identifikuar si problem parësor për zhvillimin e sektorit. Ne këtë aspekt, janë realizuar disa aktivitete, ndërsa rezultati përfundimtar i kësaj iniciative pritet ne fillim te vitit 2011, ne momentin qe konstituohet qeveria.

Ne kuadër te realizimit te objektivit te dyte, e qe ka te beje me **rritjen e imazhit pozitiv të industrisë së TIK-ut para sektorit publik dhe atij privat, përmes implementimit te fushatave të marketingut**, shoqata ka marre pjese ne organizimin e Panairit tradicional ITTF 2010, ka përgatitë materiale promovuese dhe ka bere shpërndarjen e tyre ne te gjitha konferencat, punëtoritë dhe ngjarjet tjera te organizuara ne Kosove dhe jashtë vendit.

Gjate periudhës raportuese është punuar edhe per realizimin e Objektivit te trete- **Ndihma në krijimin e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të shoqatës dhe mundësive biznesore jashtë Kosovës, përmes rrjetëzimit, ngjarjeve biznesore dhe integritit në iniciativat rajonale**, përmes organizimit te B2B takimeve, pjesëmarrjes ne Konferenca rajonale dhe ndërkombëtare, nënshkrimit te marrëveshjeve bilaterale per bashkëpunim etj.

Lidhur me objektivin e katërtë- **Zhvillimi i sistemit te edukimit dhe te shkathtësive ne pajtueshmëri me nevojat e sektorit te TIK**, shoqata ka ndërmarrë një hulumtim per evidentimin e mungesës se shkathtësive ne sektorin e TIK, pas se cilës do te punohet rreth influencimit te politikebërësve per hartimin e kurrikulave adekuate. Raporti final i këtij hulumtimi do te jete i gatshëm ne fund te shkurtit 2011.

Sa i përket realizimit te objektivit te peste- **Sigurimi i qëndrueshmërisë së shoqatës**, janë ndërmarrë hapat e identifikimit te donatoreve potencial, janë përgatitur projekte afatgjata partneriteti, si dhe është filluar procedura e hartimit te planit strategjik te zhvillimit te shoqatës.

Gjate periudhës raportuese, obligimin financiar te anëtarësimit e kane përmbushur 34 kompani apo 52.30% e numrit te gjithëmbarshtëm prej 65 anëtarësh.

Te hyrat e shoqatës gjate kësaj periudhe njëvjeçare kane qene 84,019.56€ (krahasuar me 45,887.31€ te vitit 2009), ndërsa shpenzimet kapin shumën prej 85,129.37€ (krahasuar me 38,466.00€ te vitit 2009).

Gjate vitit 2010 janë mbajtur gjashte mbledhje te Bordit, katër te rregullta dhe dy te jashtëzakonshme.

AKTIVITETET

1. Mbledhja vjetore e Kuvendit të STIKK

Aktiviteti i parë i tremujorit të parë ka qenë organizimi i Mbledhjes vjetore të Kuvendit të STIKK, i cili ka qenë i paraparë të mbahet në dhjetorin e vitit 2009, por për shkak të procesit të gjatë të punës rreth statutit të STIKK, u mbajt më 28 janar 2010. (Statuti fillestar u muar i gatshëm me rastin e regjistrimit të shoqatës. Draftimi i Statutit të ri, bazuar në projektin me Crimson Capital dhe IKT Norge, është dashur të ndihmohet nga MASIT, por pas vonës në nënshkrimin e marrëveshjes në mes të MASIT dhe Crimson Capital, u vendos që të fillohet me një iniciativë tjetër. Pas konsultimeve, Bordi aprovoi themelimin e grupit punues të përbërë prej një anëtarit të Bordit të STIKK, drejtoreshës ekzekutive të STIKK, menaxherit të programeve të Crimson Capital, specialistit të Teknologjisë Informative të programit KPEP të USAID-it si dhe konsulentit ligjor. Ky grup punues kishte për detyrë zhvillimin e një versioni të ri dhe më të përshtatshëm të Statutit dhe akteve tjera nënligjore. Versioni i parë përfundoi në nëntor 2009, dhe u vendos në forumin e anëtarëve në Uebfaqen e STIKK për komente dhe sugjerime. Aprovimi final i tij u bë në mbledhjen e Kuvendit, të mbajtur më 28 Janar 2010).

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Bordit, Driton Hapçiu, ndërsa të pranishëm ishin 40 kompani të TIK dhe 9 mysafirë, si dhe stafi i STIKK. Fjalimet përshëndetëse i mbajtën Ambasadori Norvegjez në Kosovë, z. Sverre Johan Kvale, Znj. Mary Hobbs nga Departamenti i Zhvillimit Ekonomik në USAID dhe Z. Michael Gold nga Crimson Capital.

Driton Hapçiu, kryetar i Bordit, prezantoi **punën e bordit gjatë vitit 2009**. Janë mbajtur tetë mbledhje të Bordit (4 të rregullta dhe 4 të jashtëzakonshme). Anëtarët e Bordit kanë marrë pjesë në katër konferenca ndërkombëtare, janë realizuar katër takime me qeverinë, mbi njëzet takime me palë interesi, janë nënshkruar dy marrëveshje mirëkuptimi (MASIT dhe AITA), është dërguar një draft marrëveshje për shoqatën e TIK në Greqi. Temat dhe diskutimet që Bordi i STIKK i ka trajtuar në vitin 2009 ishin: Prona Intelektuale dhe të drejtat autoriale; Tatimet, taksat doganore dhe TVSH-ja; Business Innovation / Excellence Center; Internet Exchange Point; TLD Domain-I për Kosovën; Biznes Inkubatori Kosovar për TIK; Shkollë / Institucion arsimor 3rofessional për TIK; Content Filtering për ISP-të; Punësimi dhe puna praktike për studentë; ISO standardet për sektorin ; Projekte për zhvillim dhe hulumtim; Green IT etj.

Drejtoresha e STIKK, Z.nj Vjollca Çavolli, prezantoi **raportin vjetor 2009** të punës në organizatë duke prezentuar: procedurat e themelimit të shoqatës, aktivitetet e realizuara gjatë 2009, aktivitetet në vijim dhe të hyrat e shpenzimet gjatë 2009. Poashtu u prezentuan dhe pesë objektivat kryesore për vitin 2010:

- Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK
- Rritja e imazhit pozitiv të industrisë së TIK-ut para sektorit publik dhe atij privat përmes implementimit të fushatave të marketingut
- Ndihma në krijimin e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të shoqatës dhe mundësive biznesore jashtë Kosovës
- Zhvillimi i sistemit të edukimit dhe të shkathtësive në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK (*Workforce Development*), dhe
- Sigurimi i qëndrueshmërisë së shoqatës

Përveç këtyre prezantimeve, anëtarët e Kuvendit miratuan **planin e punës dhe buxhetin për vitin 2010**, të prezantuar nga Z. Enver Doko, anëtar i Bordit.

Dokumenti i **Skemës së anëtarësisë** u prezentua nga anëtari i bordit, Z.Valon Budima. U prezentua pakoja e përbërë nga dy lloje anëtarësish: anëtarë i plotë dhe anëtarë bashkëpunues (si anëtarë bashkëpunues janë edhe anëtarët Patron dhe Sponsorët). Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit e aprovuan njëzëri këtë dokument.

Në pikën e **nominimit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të rinj të Bordit të STIKK**, anëtari i Bordit, Z.Durmishali Smani prezantoi vendimin e bordit mbi nominimin e mundshëm të vetëm katër anëtarëve të Bordit të vjetër për hir të kontinuitetit të punës, ndërsa 3 të tjerët të mos nominohen fare, në mënyrë që t'iu jepet mundësia anëtarëve të tjerë të STIKK. Të nominuarit për anëtarë të rinj të Bordit Ekzekutiv nga anëtarët e kuvendit ishin:

1. Driton Hapciu – CACTUS sh.a
2. Visar Dobroshi – IPKO
3. Durmishali Smani – ELTING Electronics
4. Shkumbin Brestovci – RROTA
5. Fatos Stavileci – ATIKOS
6. Enver Konjuhi – DataCom
7. Faton Aliu – DCE
8. Dardan Vokshi – INET
9. Burim Haxha – INFOCOM
10. Fahri Avdiu – INFOSOFT Systems Sh.p.k
11. Gazmend Kajtazi – INTERADRIA
12. Avni Haliti – INTERSOFT
13. Hevzi Cuci – ITBM Group
14. Hysen Gashi – PPC IT Solutions
15. Blin Zeqiri – Art House

Votimi i anëtarëve u bë me lista të hapura, me votim të fshehtë. Votuan gjithsej 35 anëtarë. Numrimi i votave u bë nga komisioni i përzgjedhur në fillim të mbledhjes së kuvendit.

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe në bazë të votave të mbledhura anëtarët e ri të Bordit janë:

1. Driton Hapciu – CACTUS sh.a – **28 vota**
2. Visar Dobroshi – IPKO – **23 vota**
3. Durmishali Smani – ELTING Electronics – **23 vota**
4. Shkumbin Brestovci – RROTA – **19 vota**
5. Dardan Vokshi – INET – **17 vota**
6. Fahri Avdiu – INFOSOFT Systems Sh.p.k – **17 vota**
7. Gazmend Kajtazi – INTERADRIA – **16 vota**

Promovimi Publik i Raportit të Hulumtimit të Sektorit të TIK në Kosovë 2009 dhe Raporti mbi doganat dhe TVSH e vendeve në rajon për sektorin e TIK- Kjo pikë u prezentua nga Visar Dobroshi, nënkryetar i Bordit të STIKK. Raporti i hulumtimit të sektorit të TIK në Kosovë 2009 është bërë nga IQ consulting, ndërsa është financuar nga KPEP- USAID. Qëllimi i këtij projekti ka qenë që të krijohet një pasqyrë e sektorit të TIK-ut në Kosovë dhe të zhvillojë një databazë të menaxhimit të relacioneve me klientët (CRM) për Shoqatën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve të Kosovës - (STIKK). Hulumtimi është realizuar anëmbanë Kosovës duke aplikuar intervista direkte me përfaqësuesit e top-menaxhmentit të kompanive të TIK-ut. Puna në terren është realizuar gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2009. Një ndër pengesat kryesore të dala gjatë implementimit të këtij hulumtimi ka qenë mos-gadishmëria e menaxherëve të kompanive të TIK dhe shtyerja e intervistave të aranzhuara.

Finalizimi i strukturës organizative

Në mbledhjen e rregulltë të Bordit të STIKK, të mbajtur më 8 shkurt 2010, në mesin e anëtarëve të zgjedhur të Bordit, u zgjodhen Kryetari, Nënkryetari dhe anëtarët përgjegjës të aspektit financiar të STIKK .

Përveç këtyre zgjedhjeve, janë krijuar tetë komisione punuese si dhe janë përcaktuar anëtarët e bordit që do të jetë përgjegjës për udhëzimin e këtyre komisioneve:

1. Taksat dhe Legjislacioni – përgjegjës Z. Fahri Avdiu
2. Sistemi i edukimit – përgjegjës Z. Gazmend Kajtazi
3. Telekomunikimet – përgjegjës Z. Visar Dobroshi
4. Strategjia nacionale e TIK – përgjegjës Z. Shkumbin Brestovci
5. Inkubator biznesi – përgjegjës Z. Durmishali Smani
6. Përfaqësimi ndërkombëtar – përgjegjës Z. Driton Hapçiu
7. Standardet në sektorin e TIK- përgjegjës Z. Dardan Vokshi
8. E-Qeverisja- përgjegjëse Znj. Vjollca Çavolli

2. Aktivitetet sipas objektivave

2.1. Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përsheptuar të sektorit të TIK

Njëra nga aktivitetet kryesore të kësaj periudhe ka qenë angazhimi i shoqatës rreth ndryshimit të Ligjit mbi TVSH dhe Doganat për importin e pajisjeve të IT, e identifikuar si problem prioritar për zhvillimin e sektorit. Gjatë tremujorit të dytë janë formuar edhe komisionet punuese, ku komisioni për legjislacion ka mbajtur mbledhjen e parë, në të cilën janë përcaktuar hapat e ardhshëm për përpilimin e një dokumenti rekomandues për Qeverinë lidhur me zvoglimin e taksave doganore dhe TVSH për sektorin e TIK.

Gjatë tremujorit të parë, Komisioni për Taksat dhe Legjislacion ka pasur mbledhjen e parë, më 18 mars, në të cilin morën pjesë vetëm 2 anëtarë dhe ku u caktuan hapat e ardhshëm që kanë për synim përgatitjen e Letrës Rekomanduese për Qeverinë e Kosovës, lidhur me krijimin e mundësive për zhvillim të sektorit të TIK përmes zvogëlimit të taksave doganore dhe TVSH.

Gjatë kësaj mbledhjeje, drejtoresha ekzekutive e STIKK, bëri një përshkrim të shkurtë të punës së këtij komisioni, ku dhe bëri prezantimin e raportit mbi gjendjen e tregut të TIK në Kosovë dhe në rajon, ndikimin e doganës dhe TVSH në këtë sektor, të përgatitur me anë të një hulumtimi nga z.Arben Abdullahu.

Në vazhdim z. Fahri Avdiu, njëkohësisht mbikëqyrës për mbarëvajtjen e këtij komisioni, prezantoi në pika të shkurta rëndësinë e formimit të këtij komisioni punues, si dhe propozoi disa pika për të pasur sa më shumë informata dhe për të vazhduar më tutje me krijimin e një strategjie për arritjen e këtyre qëllimeve.

Pas diskutimeve të ndryshme vendosen këto pika:

- Duhet të përkthehet raporti i lartpërmendur,
- Duhet të dërgohet një kërkesë zyrtare tek personat adekuat në doganën e Kosovës, për të marrë listën e importit të produkteve të IT në Kosovë gjatë vitit 2009, dhe atë sipas kodeve doganore,
- Duhet të dërgohet një kërkesë në Administratën Tatimore të Kosovës për të kërkuar shumën e qarkullimit të tatueshëm të sektorit të IT, dhe numrin e punëtorëve për të cilët paguhet tatimi.

Në vazhdim u caktua një afat kohor për mbledhjen e informatave të nevojshme, i cili ishte deri në e mbledhjes së radhës së bordit, ku do të prezantohet *position paper*, nga z. Fahri Avdiu, si dhe e gjithë ecuria e deritanishme e komisioni, me pastaj të caktohet mbledhja e radhës për grupin punues.

Gjatë këtij tremujori, është bërë përkthimi i hulumtimit në fjalë, janë marrë shënimet nga Doganat mbi importin e pajisjeve të TI në vitin 2009, është realizuar një takim zyrtar me Drejtorin e ATK, ku edhe është diskutuar mundësia e avokimit të këtij institucioni përmes pjesëmarrjes në këtë iniciativë, si dhe është dërguar kërkesa zyrtare në Administratën Tatimore për shënimet e lartpërmendura.

Hapat e pare te sensibilizimit te opinionit lidhur me brengen kryesore te sektorit, jane bere me pjesemarrjen e Drejtoreshes se STIKK ne workshopin e organizuar nga Friedrich Ebert Stiftung, ku STIKK-ut i eshte dhene hapesire 30 minuteshe per prezantim para deputeteve te Parlamentit, anetare te grupeve parlamentare.

Për më tepër, janë bërë bisedat e para me Odën Ekonomike të Kosovës, e cila ka shprehë gadishmërinë e saj për ta përkrahur dhe për të ndihmuar procesin e lobimit dhe avokimit në Qeveri për sektorin e TIK. Si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi, është përgatitur një Marrëveshje Mirëkuptimi nëmes të OEK dhe STIKK, e cila është nënshkruar me 10 gusht 2010.

2.1.1. Raporti i Hulumtimit të Sektorit të TIK në Kosovë 2009 dhe Raporti mbi doganat dhe TVSH e vendeve në rajon për sektorin e TIK

Në mbledhjen e kuvendit të mbajtur në Janar 2010 është prezantuar edhe studimi mbi tarifat doganore dhe TVSH në vendet e rajonit: Serbi, Maqedoni, Shqipëri dhe Kroaci. Rezultatet e këtij studimi do të përdoren nga ana e komisionit mbi legjislacion në kuadër të STIKK, në mënyrë që të bëhet avokimi tek strukturat qeveritare për mundësimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e sektorit të TIK në Kosovë. Keto dy raporte mund të shkarkohen edhe nga webfaqja e STIKK.

2.1.2. Trajnimi mbi Avokim dhe Lobim, Warshavë, Poloni

Nën iniciativën dhe organizimin e programit të USAID-World Learning, Drejtoresha Ekzekutive e STIKK mori pjesë në një vizitë pune në Poloni, më 10-14 Maj, 2010. Qëllimi i vizitës ishte njohtimi me aktivitetet e Odes Ekonomike Polake dhe shoqatave tjera biznesore, lidhur me strategjinë e avokimit dhe lobimit në Qeveri. Gjatë kësaj vizite, janë mbajtur takime me Shoqatën e përpunuesve të mishit, Business Center Club (është një klub elitare dhe organizata me e madhe e punëdhënësve privat, ka 1200 kompani anëtare), Oda Ekonomike e Polonisë, Shoqata e fermerëve dhe Shoqata e TIK e Polonisë (e cila premtoi mbështetjen e saj gjatë aplikimit të STIKK në Digital Europe).

2.1.3. Prezantimi i parë publik i Rekomandimeve të STIKK lidhur me heqjen e doganës dhe zvogëlimin e TVSH për mallra dhe shërbime të TIK

Në datën 13 shtator 2010, me iniciativën e DFID, Këshilli Konsultativ për NVM në kuadër të MTI organizoi mbledhjen e tretë të rregullt në ambientet e Hotel Grand. Në prezencën e Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, z. Lutfi Zharku, Ambasadorit të Mbretërisë së Bashkuar, z. Andy Sparks si dhe përfaqësuesve të Qeverisë dhe të komunitetit të donatorëve, u prezantuan 3 iniciativa të

shoqatave të biznesit. Në këtë ngjarje STIKK bëri prezantimin e parë publik të rekomandimeve të saj lidhur me heqjen e doganës dhe zvogëlimin e TVSH për mallra dhe shërbime të TIK.

Pas prezantimit të AmCham lidhur me vonesat mbi kryerjen e pagesave në bizneset private dhe publike dhe prezantimit të OEK lidhur me problemet me regjistrimin e bizneseve, STIKK prezantoi rekomandimet për Qeverinë lidhur me heqjen e doganës dhe uljen e normës së tatimit në vlerën e shtuar për mallrat dhe shërbimet e TIK, e cila gjë do të mundësonte rritjen e konkurrueshmërisë së kompanive vendore si dhe zhvillimin e tregut në këtë sektor krahas vendeve tjera të rajonit.

Në fund të takimit, hulumtimet dhe rekomandimet e bëra nga shoqatat e biznesit u përshëndetën nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë si dhe nga Ambasadori, me ç'rast edhe u dhanë premtime se do të vazhdohet kjo formë e bashkëpunimit si dhe do të punohet rreth fuqizimit të Këshillit Konsultativ të NVM-ve, si ndërmjetësues në mes të sektorit privat dhe Qeverisë.

2.1.4. Anëtarësimi në Këshillin Konsultativ të NVM

Me 30 gusht 2010, u mbajt takimi i parë me z. Naser Grajqevcin, Drejtor i Këshillit Konsultativ për NVM, ku dhe u diskutua anëtarësimi i STIKK në Këshillin Konsultativ. Gjate këtij takimi, z. Grajqevci u informua për iniciativën e STIKK, lidhur me heqjen e doganës dhe uljen e normës së tatimit në vlerën e shtuar për mallrat dhe shërbimet e TIK, krahas vendeve tjera të rajonit, te cilit gjithashtu iu dorëzuan të gjitha dokumentet e përgatitura lidhur me këtë iniciativë. Poashtu, STIKK dorëzoi kërkesën për anëtarësim në Këshillin Konsultativ të NVM me 7 shtator, 2010, për të cilën jemi informuar që në bazë të udhëzimit administrativ Nr. 2008/14 për themelimin e Këshillit Konsultativ të NVM-ve, konkretisht neni 2, pika 2 parasheh që "Anëtarët e Këshillit Konsultativ të NVM-ve" emërohen me vendim nga Ministri i MTI-se i cili ka mandat 4 vjeçar, prandaj me rastin e emërimit të ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë do të ofrohet kërkesa dhe do të procedohet me tutje.

2.1.5. Takim me Departamentin e Politikave Ekonomike dhe Fiskale, Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Pas marrjes së informatës se departamenti i politikave ekonomike dhe fiskale ka për të propozuar ministrit Shala paketën e ndryshimeve fiskale për sektorët e biznesi, gjegjësisht lirim nga taksat doganore të disa sektorëve me interes ekonomik për Kosovën, STIKK është takuar me datën 30 Shtator 2010, me znj. Nashide Bajrami dhe znj. Lindita Toçi, të cilave i është prezantuar i gjithë dokumentacioni i përgatitur nga ana e STIKK, lidhur me lirim nga TVSH dhe Dogana. Departamenti në fjalë ka marr përsipër obligimin për t'ia prezantuar këtë iniciativë Ministrit Shala, por ky takim nuk është realizuar ende për shkak të situatës aktuale politike.

2.1.6. Bashkëpunimi me DFID /Fuqizimi i dialogut publiko-privat

Në kuader të projektit të DFID "Mbështetja për Zhvillimin e Sektorit Privat në Kosovë" përmes fuqizimit të Këshillit Konsultativ të NVM dhe njëkohësisht fuqizimit të shoqatave të biznesit për të ndikuar në politikën zhvillimore, STIKK është perzgjedhur si njeri nga perfituesit e kësaj iniciative, krahas me Oden Ekonomike të Kosovës dhe Oden Ekonomike Amerikane të Kosovës. Në kuader të këtij projekti është mbajtur takimi i parë në mes të kontraktorit të DFID, z. Driton Dalipi dhe anëtarëve të bordit të STIKK. Gjate këtij takimi është diskutuar lidhur me pjesën e strategjisë të cilat janë me të rëndësishme për sektorin e TIK, dhe për të cilat do të mund të përgatiten rekomandimet të cilat pastaj do të prezantohen para Këshillit Konsultativ të NVM-ve. Në nderkohe, STIKK ka aplikuar për të qenë anëtarë e Këshillit Konsultativ, ndërsa përgjegjja në këtë aplikim nuk është marrë ende për shkak të rrethanave politike të krijuara në këtë tremujor.

Gjate muajit tetor, nen organizimin e kontraktorit nga DFID, z. Driton Dalipi është mbajtur një punëtori ne Tirane, Shqipëri, ku morën pjesën shoqatat e biznesit (STIKK, OEK dhe AMCHAM). Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që ne bashkëpunim me konsulentin e angazhuar nga DFID z. Ilir Rambeci, të punohet ne identifikimin e sfidave të sektorit të Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës.

Gjate tremujorit të fundit janë realizuar takime të vazhdueshme me konsulentët e angazhuar enkas për të ndihmuar ne identifikimin e tri çështjeve më me prioritet për sektorin e TIK. Eksperti ligjor z. Emrush Ujkani, eksperti i dialogut publiko privat, z. Gavril Lasku, dhe ekspert i NVM-ve, z. Ilir Rambeci, kanë punuar ne përpilimin e dokumentit pozicionues të STIKK, i cili të do të prezantohet ne mbledhjen e ardhshme të Këshillit Konsultativ të NVM-ve.

2.1.7. E drejta pronësore intelektuale

STIKK, në bashkëpunim me Programin e Qeverisë Amerikane "Commercial Law Development Program-CLDP, organizuan punëtorinë e dytë mbi të drejtën pronësore intelektuale për industrinë e TIK në Kosovë, më 9-11 mars 2010.

Objektivat kryesore të seminarit ishin:

- Kontributi në zbatimin e të drejtave të pronës intelektuale në Kosovë, duke ndihmuar udhëheqësit e industrive vendore të kuptojnë përfitimet e zhvillimit të pronës së tyre intelektuale dhe t'i demonstrojnë atyre përparësitë e zbatimit të të drejtave të pronës intelektuale.
- Thellimi i kuptimit të konceptit të pronës intelektuale dhe licensimit të software.
- Përgjigjja e të dyja pyetjeve të thjeshta dhe komplekse të cilat kanë dalë në sektorin e TIK në Kosovë si rezultat i mjedisit të ri biznesor, siç janë marrëveshjet e licensimit të softwareve dhe ndërtimin e kapaciteteve menaxheriale.

Temat e diskutuara:

- Testimi i licensave / përdoruesit e licensave / kanalet & shpërndarja e licensave / - Pse angazhohen avokatët për të hartuar marrëveshjet e licensimit?
- "US v. EU law covering software licensing agreements -the purpose, importance, important terms and conditions of licensing agreements -Join Venture Licensing Agreements: who owns what?"
- Burime të hapura (open Source): zhvillimi i modeleve të licensimit

Seminari ka kontribuar për të përmirësuar nivelin e njohurive për të drejtat e pronësisë intelektuale (IPR). Për më tepër, duke pasur parasysh se në një të ardhme të afërt rëndësia e IPR do të vazhdojë të rritet, është gjithashtu e nevojshme për të vazhduar me fazat e tjera të seminarit, me modelet e reja të trajnimit.

2.1.8. Konferenca njëditore mbi BPO (Business Process Outsourcing)

U mbajt më 14 prill, në Hotelin Grand, me pjesëmarrjen e 43 përfaqësuesve nga sektori i TIK, donatorëve dhe përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës.

Gjatë konferencës u mbajtën disa prezantime, duke filluar me një prezantim të Znj. Michelle Messina (konsulente e angazhuar nga KPEP), e cila u bazua në përvojën e saj në vende të ndryshme të botës. Më pastaj, u prezantua strategjia e IPAK mbi zhvillimin e BPO si dhe trendet aktuale dhe procedurat legjislative lidhur me themelimin dhe funksionimin e Qendrave të Thirrjeve në Kosovë, prezantuar nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit. Përveç kësaj, u prezantua edhe studimi i KPEP lidhur me Qendrat e Thirrjeve, duke u fokusuar në gjetjet dhe pengesat, të identifikuara nga vetë respondentët. Pjesa më interesante e Konferencës ishin prezantimet e 3 kompanive (qendra të thirrjeve/ofrues të shërbimeve), duke i theksuar mendimet dhe përvojat e mira dhe të këqija të tyre.

Në periudhën e pasdites nuk u realizua punëtorja e paraparë me agjendë, për shkak të numrit të vogël të pjesëmarrësve.

Hapi vijues pas kësaj konference do të jetë përpilimi i një "Position Paper" për këtë industri në rritje e sipër.

2.1.9. Prezentimi publik i manualit të së drejtës pronësore intelektuale për zhvilluesit softuerik

Pas suksesit të dy workshopeve të mbajtura në shtator 2009 dhe mars 2010 lidhur me Te Drejtën Pronësore Intelektuale (IPR), është mbajtur **Prezantimi publik i Manualit të së Drejtës Pronësore Intelektuale për zhvilluesit softuerik**- Kjo ngjarje u organizua nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës-STIKK, në bashkëpunim me USAID/Programi për Ndërmarrje Private të Kosovës dhe Commercial Law Development Program CLDP, dhe është mbajtur me 26 tetor në Hotel Afa me ç'rast autorja e këtij manuali znj. Luljeta Plakolli e prezantoi manualin dhe prezantimi vazhdoi me diskutime të ndryshme rreth këtij manuali.

2.2. Objektivi 2. Rritja e imazhit pozitiv të industrisë së TIK-ut para sektorit publik dhe atij privat përmes implementimit të fushatave të marketingut

2.2.1. Panairi "Pristina ITTF Fair 2010"

Shoqata bashkëorganizoi dhe muar pjesë në Panairin tradicional ITTF 2010, i cili u mbajt më 27-29 maj, 2010. Sivjet, në këtë panair morën pjesë 68 kompani nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Turqia, Greqia, ShBA, Britania e Madhe, Austria, dhe Zvicra.[]

2.2.2. STIKK sjell teknologjinë e fundit pranë fëmijëve

Në festivalin e fëmijëve "Lojë për të Gjithë", të organizuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe IQ Consulting më 14-19 qershor, morën pjesë edhe STIKK së bashku me kompanitë anëtare Rrota, Appdec, Flosk dhe Komtel, në tendën "Hi-tech për fëmijë". STIKK dhe kompanitë prezantuan lojëra kompjuterike edukative dhe argëtuese, si dhe dhuruan pajisje të TI për SOS Fshatin e Fëmijëve. Në punëtoritë e Festivalit morën pjesë rreth 7000 fëmijë nga mbarë Kosova.

2.2.3. Përvjetori i dytë i STIKK

Me datën 7 dhjetor, STIKK festoi 2-vjetorin e themelimit, me ç'rast organizoi një koktej në restorantin Villa Germia, ku të ftuar ishin të gjitha kompanitë anëtare të STIKK, Ambasadori i Mbretërisë Norvegjeze, Crimson Capital, USAID, GTZ, JICA dhe shumë të tjerë nga komuniteti i donatorëve, përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe përfaqësuesit e dy kompanive musafire norvegjeze të IT. Gjatë kësaj ceremonie, Drejtoresha Ekzekutive e STIKK, Znj. Vjollca Cavolli mbajti një fjalim rasti, ku tregoi për sukseset, sfidat dhe planet e së ardhmes të STIKK. Gjithashtu, publikisht falënderoi të gjithë ata që kontribuan dhe përkrahën zhvillimin e STIKK gjatë këtyre 2 viteve. Fjalim po ashtu mbajti Ambasadori Norvegjez, Z. Sverre Johan Kvale, Z. Gregory Olson nga USAID, Z. Michael Gold nga Crimson Capital, Z. Dalip Dewon nga IKT-Norge dhe Z. Durmishali Smani, Kryetar i bordit të STIKK.

Në fund të fjalimeve përshëndetëse, Z. Durmishali Smani, ndau mirënjohje për përkrahësit e STIKK (Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë, Crimson Capital, USAID, GTZ, IKT Norge dhe APIK (Agjensioni për promovim të investimeve).

Poashtu, mirënjohjet u ndanë edhe për ish anëtarët e Bordit të STIKK: Z. Enver Doko nga Comtrade Computers, Z. Valon Budima nga Asseco, Z. Visar Dobrosi nga IPKO dhe Z. Agon Baruti nga Komtel, për kontributin e dhënë gjatë vitit të parë të aktiviteteve të STIKK. Në këtë ceremoni morën pjesë më shumë se 80 persona.

2.3. Objektivi 3. Ndhimja në krijimin e lidhjeve ndërmjet anëtarëve të shoqatës dhe mundësive biznesore jashtë Kosovës, përmes rrjetëzimit, ngjarjeve biznesore dhe integritit në iniciativat rajonale

2.3.1. Përfaqësimi i parë i Kosovës në CeBIT 2010

Në vazhden e përkrahjes së Programit KPEP të USAID-it, gjatë tremujorit të parë është realizuar projekti i përfaqësimit të parë të Kosovës në Panairin më të madh botëror të Teknologjisë së Informacionit, CeBIT 2010, i cili u mbajt në Hannover, Gjermani, prej 2-6 Mars 2010.

Ftesa për panair erdhi nga organizata zvicerane për promovimin e investimeve-SIPPO, e cila i mundësoi STIKK-ut të marrë pjesë në këtë panair me një stendë falas, ndërsa dy kompanive kosovare Cactus dhe Expik i mbuloi një pjesë të shpenzimeve rreth stendave të tyre. Përpos këtyre dy kompanive të TIK, në panair ishin prezent edhe dy kompani tjera: Appdec dhe Computertrade, të cilat e shfrytëzuan stendën e STIKK për ti promovuar produktet e tyre si dhe për ti realizuar takimet me partnerët ekzistues dhe ata potencial. Rreth 3000 vizitorë të CeBIT-it janë informuar për tregun kosovar të TIK edhe përmes broshurave dhe katalogut të kompanive të përgatitur nga STIKK.

Në ditën e dytë të panairit, prezent në stendën kosovare ishte edhe Ambasadori i Kosovës në Gjermani, Z. Vilson Mirëdita, me ç'rast u bë edhe promovimi i sektorit të TIK përmes intervistave në RTV 21 dhe PC World.

2.3.2. Takimi B2B për bizneset Kosovare dhe Maqedonase

nën mbështetjen e Agjencionit për Promovim të Investimeve të Kosovës (IPAK), STIKK-u, AmCham dhe CEED organizuan një takim B2B në mes të kompanive kosovare dhe kompanive maqedonase më 11 mars, 2010 në Prishtinë. Kompanitë nga Maqedonia dhe Kosova u mbledhën në një takim një ditë për të diskutuar mbi klimën e investimeve në Kosovë dhe Maqedoni, mundësitë e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit.

Të pranishëm në këtë ngjarje ishin mbi 50 kompani Kosovare dhe Maqedonase. Ky takim B2B ishte një mundësi e shkëlqyer për komunitetin e biznesit në Kosovë dhe Maqedoni për ta lidhur dhe për të forcuar bashkëpunimin.

2.3.3. Takimi rajonal B2B i kompanive të TIK

u realizua më 7-8 prill, në Shkup, Maqedoni, qëllimi i të cilit ishte sjellja e bizneseve dhe shoqatave të TIK nga vendet e ndryshme, për tu ofruar mundësinë e partneritetit dhe të rrjetëzimit. Pjesëmarrja në këtë ngjarje u ka mundësuar kompanive të gjejnë blerës për produktet dhe shërbimet e veta, ofrues të produkteve dhe shërbimeve, partnerë për projekte të financuara nga donatorët si dhe investitorë potencial.

Ngjarja filloi me prezantime te ndryshme në temat vijuese: Trendet globale ne sektorin e TIK; Programet e financuara nga fondet e EU per sektorin e TIK; Pervojat me te mira ne fushen e TIK ne EU, SHBA, Azi etj,

2.3.4. B2B midis kompanive të Kosovës dhe Shqipërisë dhe krijimi i rrjetit mbarëkombëtar të komunitetit të Teknologjisë së Informacionit

Në datën 1 korrik 2010 në mjediset e Hotel Sheraton në Tiranë u mbajt takimi i parë mbarëkombëtar B2B midis kompanive të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe u mundësua krijimi i rrjetit mbarëkombëtar të komunitetit të Teknologjisë së Informacionit nga Kosova, Shqipëria, dhe Maqedonia.

Ky takim u organizua nga Shoqata për Teknologji te Informacionit dhe Komunikimit te Kosovës STIKK në bashkëpunim me homologun e saj në Shqipëri (AITA), ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga kompanitë private, komuniteti profesional, organizata dhe donatorë te huaj, si dhe përfaqësues te Qeverise se Shqipërisë, kryesisht të sektorit të Teknologjisë së Informacionit.

Ky aktivitet u përshëndet nga z. Genc Pollo, Ministër për Inovacion dhe Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit në Qeverinë e Shqipërise, Ambasadori i Mbreterise së Norvegjisë, z. Sverre Johan Kvale, z. Grigor Joti, President i AITA-s, z. Durmishali Smani, Kryetar i Bordit të STIKK, z. Mark Walder, nga Programi i USAD-it për Ndërmarrje Private të Kosovës , dhe z. Dritan Mezini, Kryetar i AITA-s.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte i një rëndësie të veçantë, pasi mundësoi arritjen e objektivave te mëposhtme:

1. Organizimin e takimit Biznes për Biznes (B2B) mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, që ka si qëllim kryesor shkëmbimin e përvojave dhe mundësive te bashkëpunimit
2. Krijimin e rrjetit professional mbarëkombëtar te Teknologjisë se Informacionit
3. Caktimin e datës 1 Korrik si dita mbarëkombëtare e Teknologjisë se Informacionit
4. Forcimi institucional i shoqatave respektive, dhe zhvillimi i rolit te tyre si një nga aktorët kryesorë ne këtë sektor.

Në këtë event ishin të pranishëm 111 përfaqësues, 11 ishin nga Kosova, 71 nga Shqipëria, 3 nga Maqedonia dhe 26 nga Organizata te ndryshme joqeveritare.

2.3.5. STIKK firmos Marrëveshje te Mirëkuptimit me OEK

Me datën 10 gusht 2010, në sallën e konferencave A/1 të Odës Ekonomike te Kosovës, u firmos Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës dhe Odës Ekonomike të Kosovës, ku pjesëmarrës ishin kompanitë e TIK- anëtare të STIKK, përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës si dhe mysafirë të shumtë nga komuniteti i biznesit dhe i donatorëve.

Marrëveshjen e nënshkruan z.Safet Gërxhaliu, Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës dhe z. Durmishali Smani, Kryetar i Bordit të STIKK.

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është që këto dy Shoqata të japin kontributin maksimal në ngritjen dhe intensifikimin e veprimeve për interesa të përbashkëta, në asistimin, promovimin, këmbimin e informatave, në implementimin dhe realizimin e projekteve për përkrahjen e komunitetit të biznesit kosovar, ofrimin e përbashkët të shërbimeve si dhe mbështetje konstruktive në institucionet qeveritare dhe ndërkombëtare.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes u organizua një koktej, ku pjesëmarrësit diskutuan dhe premtuan që kjo marrëveshje nuk do të mbetet vetëm në sirtar por do të jetë fillim i një bashkëpunimi, lobimi për zgjidhjen e problemeve dhe avansimin e standardeve të bizneseve kosovare në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm.

2.3.6. Delegacioni Turk i IT viziton Kosovën

Me datën 07 shtator 2010, në zyre të Odës Ekonomike të Kosovës, u mbajt takimi në mes të Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës-STIKK dhe Delegacionit të biznesit Turk (16 pronarët dhe menaxherët e firmave më të mëdha telekomunikuese të Turqisë) në fushën e telekomunikimit.

Në këtë takim ishin prezent edhe Oda Ekonomike e Kosovës, Agjencioni për Promovim të Investimeve-IPAK, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit- ART, Kryetari i Bordit të STIKK, Z. Durmishali Smani si dhe disa kompani kosovare të fushës së telekomunikimit. Pas fjalës përshëndetëse të sekretarit të OEK, Z. Berat Buzhala, pasuan prezantimet e Z. Ekrem Hoxha, drejtor i ART mbi procedurat e licencimit të operatorëve, prezantimi i Z. Liridon Latifi nga IPAK mbi lehtësirat që Qeveria e Kosovës i ofron investitorëve të huaj si dhe prezantimi i Znj. Vjollca Cavolli nga STIKK mbi sektorin e TIK në Kosovë. Pas këtyre prezantimeve, u realizuan edhe disa takime bilaterale në mes të kompanive nga Turqia dhe Kosova.

Në fund të takimit, Delegacioni Turk shprehu kënaqësinë për ofrimin e mundësisë për zhvillimin e bisedave me kompanitë dhe institucionet kosovare dhe e cilësoi këtë ngjarje si fillim të mbarë të bashkëpunimit të ardhshëm Turko- Kosovar.

2.3.7. Seminari mbi E-Qeverisjen, Portorozh, Slloveni

Me datën 5-7 tetor, drejtoresha ekzekutive e STIKK znj. Vjollca Cavolli mori pjesë në seminarin treditor, i cili është organizuar nga Qendra për zhvillimin e e-Qeverisjes/CeGD, ku tema kryesore e kësaj ngjarje ishte identifikimi i nevojave për zhvillimin e shoqërive të informacionit si dhe perspektiva e hartimit të politikave, rregulloreve ligjore dhe zgjidhjen e sfidave të TIK në rajonin e Evropës Juglindore. Përkrah Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit, pjesëmarrës ishin edhe zyrtarë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, zyrtar të Institucioneve Qeveritare të vendeve të Evropës Juglindore, zyrtar të Qeverisë Sllovene, përfaqësues të Akademisë si dhe kompanitë lidere në këtë industri. Gjatë seminarit u diskutua për potencialet e vendeve të rajonit në tregun e sektorit të TIK rreth zhvillimit të mëtutjeshëm të e-Qeverisjes me synim të ofrimit të shërbimeve më të mira ndaj qytetareve dhe sektorit të biznesit. Kjo ngjarje u shfrytëzua edhe për krijimin e kontakteve si dhe shkëmbimin e përvojave të ndryshme të sektorit publik si dhe të atij privat. Në këtë konferencë, STIKK u prezantua nga ana e DE Vjollca Cavolli, ndërsa të gjitha shpenzimet u mbuluan nga ana e organizatorit.

2.3.8. Konferenca e 8-të e SEEITA-së, takimi i 7-të i forumit të TIK të Evropës Juglindore dhe konferenca e 7-të e ditëve të hapura të MASIT

Në konferencën e 8-të të SEEITA-së, pjesë përbërëse e të cilës ishte takimi i 7-të i forumit të TIK të Evropës Juglindore dhe gjithashtu konferenca e 7-të e ditëve të hapura të MASIT, morën pjesë kryetari i Bordit të STIKK z. Durmishali Smani, drejtoresha ekzekutive e STIKK znj. Vjollca Cavolli dhe dy asistentet e projekteve. Konferenca në fjale u mbajt në ambientet e Hotelit Metropol, më 14-15 tetor 2010, në Ohër, Maqedoni.

Pjesëmarrja ne këtë ngjarje ishte një rast i mire për ta promovuar shoqatën ne arenën rajonale, poashtu për tu njoftuar me përvojat e te tjerëve ne fushën e TIK. Përveç dëgjimit te temave interesante te trajtuara gjate kësaj konference, si psh. “Digital divide fenomenom” si dhe sfidat dhe çështjet e përbashkëta me “Mobile Broadband Technologies”, Drejtoresha Ekzekutive e STIKK, Znj. Vjollca Cavolli prezantoi punimin “Ndikimi i TIK ne bizneset kosovare”.

2.3.9. Konferenca e TIK në Bullgari

Me 18 dhe 19 tetor, DE znj. Vjollca Cavolli, dhe kryetari i komisionit për marrëdhënie ndërkombëtare z. Driton Hapciu, morën pjesë konferencën “SPI (Software Process Improvement) meets in Sofia 2010”. Organizatorë të kësaj konference ishin European Software Institute (ESI) në bashkëpunim me Software Engineering Institute (SEI), ndërsa diskutimet që u zhvilluan ishin lidhur me sfidat aktuale të kompanive te zhvillimit të softuerit dhe shumëllojshmërinë e zgjidhjeve dhe mundësitë e së ardhmes. Kjo konference shërbeu si forum për kompanitë e rajonit të cilat raportuan dhe shkëmbyen përvojat në përmirësimin e aftësive të tyre në proceset softuerike. Me 20 tetor u mbajt punëtorja “Building Regional ICT competitiveness”, me pjesëmarrjen e shoqatave rajonale te TIK, ndërsa temat e trajtuara ishin lidhur me Trendet globale të zhvillimit te TIK si dhe modelet e qëndrueshme per zhvillimin e TIK ne Evropën Juglindore. Në këtë pjesë, Z. Driton Hapciu përfaqësoi STIKK-un me temën: Transformimi i “Kapacitetit nacional” ne “Konkurrueshmëri rajonale”.

2.4. Objektivi 4. Zhvillimi i sistemit te edukimit dhe te shkathtësive ne pajtueshmëri me nevojat e sektorit te TIK (Work force Development)

2.4.1. Trajnimi mbi CRM (Customer Relationship Management)

Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës – STIKK, me përkrahjen e Programit për ndërmarrje private në Kosovë – KPEP/ Booz Allen Hamilton – USAID, organizoi 2 punëtori mbi menaxhimin e marrëdhënieve me klient-CRM, në ambientet e Villa Gërmia, me datë 1 dhe 2 Prill 2010.

Pjesëmarrës në ditën e parë të punëtorisë ishin 22 përfaqësues të kompanive të sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të Kosovës, ndërsa ditën e dytë ishin gjithsej 13 përfaqësues të shoqatave tjera të biznesit.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte trajnimi i kompanive të sektorit të TIK për rëndësinë e CRM , duke vënë në fokus nevojat e klientëve më profitabil për kompaninë, segmentimin e tyre sipas nevojave, menaxhimin e procesit të shitjes, bashkëveprimin me konsumatorë, në mënyrë që të arrijnë sukses në marrëdhëniet me klientë, ndërsa për shoqatat, trajnimi iu mundësoi që të mësojnë më tepër si të menaxhojnë marrëdhëniet me anëtarët e tyre, bazat e shënimeve, shitjen e shërbimeve, shitjen e produkteve (trajnimet, hulumtimet etj.)

2.4.2. Skills Gap Analysis – Identifikimi i mungesës se shkathtësive ne sektorin e TIK

Pas përfundimit te fazës se pare te projektit, e cila përmbante zhvillimin e metodologjisë se projektit, si dhe formulimin e pyetësorit për kompanitë e sektorit te TIK, dhe pyetësorit për Institucionet dhe Qendrat për Trajnim Profesional, ne muajin dhjetor ka filluar faza testuese e pyetësorit. Gjate muajit janar pritet te perfundohet puna ne terren, ndersa drafti i pare i studimit parashihet ne fillim te muajit shkurt.

Ky projekt mbështetet nga programi per ndermarrje private (KPEP) i USAID.

2.4.3. Call Center Training – Trajnimi i agjenteve te Qendrave te thirrjes

Ende është ne fillim te fazës te implementimit, është duke u punuar ne metodologjinë e projektit, gjithashtu është bere shpallja publike ne te përditshmen Koha Ditore, dhe ueb faqen e STIKK, për shprehje te interesimit për qendrat ekzistuese te thirrjeve si dhe ato ne formim e sipër për te bashkëpunuar ne kuadër te këtij projekti, si dhe për te gjitha kompanitë/ OJQ te cilat kane mundësi te ofrojnë shërbime te trajnimeve. Ky projekt mbështetet nga programi per ndermarrje private (KPEP) i USAID.

2.4.4. Trajnimi i Stafit te STIKK

Me qellim te ngritjes se kapaciteteve te stafit ne lëmire e menaxhimit te projekteve, me datën 20-24 shtator, z. Bardh Kadiu dhe znj. Njomza Uka, moren pjese ne trajnim Cikli i Menaxhimit te Projekteve, i cili u mbajt ne Durres, Shqipëri, nen organizimin e MDA.

2.4.5. Seminar mbi e-Qeverisjen për komuna

Me 8 dhjetor, STIKK në bashkëpunim me organizatën norvegjeze KS (shoqata e komunave te Norvegjisë) dhe organizaten e tyre lokale KS-Kosova, organizuan një seminar mbi e-Qeverisjen, të dedikuar për komunat, i cili u mbajt ne Grand Hotel.

Ne këtë seminar u prezantuan Roli dhe përgjegjësitë e Komunave, bazuar ne Strategjine e e-Qeverisjes dhe Planin e Veprimit 2009-2015 (dokument i Ministrise se Administrates Publike); Statusi i implementimit të Projektit për e-Qeverisje në Komunat e Kosovës – Rezultatet e hulumtimit të kryer (KSKosova); Përvojat e Qeverise Norvegjeze lidhur me implementimin e projekteve te e-qeverisjes, sfidat dhe rezultatet, si dhe u diskutua mbi ate se si munden Kompanitë e IT-së në Kosovë të kontribojnë në realizimin e strategjive dhe planeve të veprimit të e-Qeverisjes në Komuna. Shpenzimet e organizimit u mbuluan nga shoqata norvegjeze.

2.5. Objektivi 5. Sigurimi i qëndrueshmërisë së shoqatës

2.5.1. Vizita në Oslo, Norvegji

Duke iu pergjegjur fteses se shoqates se TIK te Norvegjise (IKT Norge), Drejtoresha Ekzekutive e STIKK, Znj. Vjollca Cavolli dhe Z. Driton Hapciu, nenkryetar i Bordit dhe kryetar i komisionit per perfaqesim nderkombetar te STIKK, vizituan Oslon, më 4-7 maj. Gjate vizites u realizuan disa takime pune si dhe u vizituan disa kompani te medha te reciklimit, perفشire edhe Stena Miljø, nje nder fabrikat me moderne te grumbullimit, sistemimit dhe reciklimit ne Evrope; El-Retur, kompani e cila mirret me "Take-back system" te grumbullimit te pajisjeve elektrike dhe elektronike. Poashtu, u vizitua edhe Qendra e Inovacionit ne qytetin Drammen, ku u prezantuan aktivitetet e kompanive te ndryshme si: Papirbredden Innovasjon, FriProg, Innovasjon Norge, Athene Prosjektledelse dhe Driv Inkubator.

Perveç ketyre takimeve dhe prezantimeve, perfaqesuesit e STIKK paten rastin te takohen me menaxherët e IKT Norge, qe mbulonin fusha te ndryshme: Green IT; Internet dhe New Media; dhe Relacioni me Qeverine.

2.5.2. Reciklimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike

Si rezultat i takimeve gjatë vizitës në Oslo, idea mbi fillimin e një projekti mbi reciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike u bë sfiduese për bashkëbiseduesit norvegjez, dhe si rrjedhojë e këtij diskutimi, Z. Hans Thorvald Loken vizitoi Kosovën më 7-10 qershor për të bërë studimin e fizibilitetit.

2.5.3. Qendra e Inovacionit (Innovation center/Hub)

Projekti i dytë i diskutuar në Oslo ka të bëjë me themelimin e një Qendre të Inovacionit, në formë të mbështetjes së individëve kreativ dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Delegacioni i pare nga Norvegjia vizitoi Kosovën më 17 dhe 18 qershor 2010, me qëllim të identifikimit të gjendjes faktike dhe të partnerëve të mundshëm për themelimin e një Qendre të Inovacionit për sektorin e TIK.

Vizita e dytë e Delegacionit Norvegjez Leiv Eirikson Innovation Center (Len), u realizua me 31 Gusht dhe 01 Shtator 2010, me qëllim të identifikimit të gjendjes faktike dhe të partnerëve të mundshëm për themelimin e një Qendre të Inovacionit për sektorin e TIK. Gjate kësaj vizite u mbajtën takime të shumta duke filluar me Ministrin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, z. Enver Hoxhaj, znj. Flora Arifi nga USAID, z. Besnik Krasniqi, Business Support Centre Kosovo (BSCK), z. Philip Hostert SPARK. Qendra do të mbështeste individët kreativ dhe bizneset e vogla dhe të mesme. Vizita e ardhshme me planin konkret për themelimin e qendrës, është parapare për në fillim të vitit 2011.

2.5.4. Vizita në Hagë, Holandë, 1-4 qershor, 2010

Qëllimi i kësaj vizite ishte pjesëmarrja në përgatitjen e programit mbi mbështetjen e bizneseve dhe ofruesve të shërbimeve, në partneritet me BID Network dhe SPARK, i cili program ka gjasa të financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës.

Gjate periudhës raportuese, partneriteti me organizatat holandeze BiD Network dhe SPARK, për implementimin e projektit të mbështetjes së NVM-ve në Kosovë, u kurorëzua me sukses, pasi që projekti u aprovua nga ana e qeverisë holandeze. STIKK, si partner lokal do të jetë përgjegjës për zhvillimin e hallkës lidhëse të vlerave në sektorin e TIK, me theks të posacem në mbështetjen e ndërmarrjes dhe NVM-ve. Projekti është aprovuar në nëntor të këtij viti, ndërsa detajet e partneritetit kanë mbetur të diskutohen në fund të janarit. Kohezgjatja e projektit është planifikuar të jetë 5 vite.

2.5.5. Bashkëpunimi me shoqatën e TIK të Hungarisë

Komunikimi me shoqatën hungareze të TIK ka filluar gjatë pjesëmarrjes së STIKK në CeBIT. Si rezultat i këtij komunikimi të suksesshëm, është krijuar një partneritet i qëndrueshëm, i cili ka rezultuar me aplikim në fondet e IPA (Socio-economic partnership programme), i cili ka të bëjë me harmonizimin e ligjeve ekzistuese në sektorin e TIK, me ato të Acquis Communitarie. Për fat të keq, ky projekt nuk ka kaluar, mirpo partneriteti i krijuar do të shfrytëzohet në të ardhmen.

2.5.6. Mbeshtetja e STIKK për AITA (Albanian IT Association)

Në partneritet me IKT Norvegje dhe Crimson Capital, STIKK do të jetë partner implementues në projektin e mbështetjes së shoqatës së IT nga Shqipëria. Në kuadër të projektit të financuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, roli i STIKK është që të ofrojë asistencë teknike shoqatës simotere nga Shqipëria.

2.5.7. Projekti STIKK 2

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2010, është përgatitur një projekt propozim nga ana e Crimson Capital dhe IKT Norvegje për mbështetjen e STIKK për një periudhë njëvjeçare. Projekti është dorëzuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, ndërsa rezultatet priten deri në fund të shkurtit.

2.5.8. Anetaresimi

Në tremujorin e parë ka filluar edhe arkëtimi i anëtarësisë për vitin 2010, ku deri më 31 mars 25% të kompanive anëtare kanë përmbushur obligimet e tyre, më 30 qershor anëtarësinë e kanë paguar 31 kompani anëtare, ndërsa në fund të vitit ky numer ka arritur shifrën 34 (52.30%).

2.5.9. Zhvillimi i Planit Strategjik 2011-2013

Gjate muajit nëntor STIKK është angazhuar për zhvillimin e planit strategjik për 3 vitet e ardhshme. Për këtë aktivitet, STIKK ka pranuar asistencën teknike nga ekipi i programit KPEP të USAID. Është formuluar një pyetësor dhe janë intervistuar rreth 15 kompani anëtare të STIKK. Gjate muajit janar është e parapare të mbahet edhe një workshop me anëtarët e STIKK, ku do të diskutohen disa prej pikave që janë dhënë si rezultat nga intervistat, do të diskutohen objektivat e ardhshme të shoqatës si dhe do të punohet drafti përfundimtar i Strategjise trevjeçare të STIKK.

Gjate kësaj periudhe, STIKK pati takime të shumta me donatore potencial, partner të ndryshëm për implementim të koordinuar si dhe përfaqësues të Qeverisë, si psh: UNICEF, Swiss Cooperation Office, GTZ, SPARK/BiD Network, IFC, JICA, Ambasada Norvegjeze, Universiteti i Prishtinës etj.

2.5.10. Bashkëpunimi ndërmjet STIKK dhe IDC

Duke marrë parasysh rëndësinë e raportit vjetor të përgatitur nga IDC, STIKK mbajti disa takime gjatë muajit shtator, me Z. Mentor Shaqiri, përfaqësues i IDC në Kosovë, me qëllim të arritjes së një marrëveshje mirëkuptimi, për blerjen e raportit nga ana e STIKK për anëtarët e shoqatës me një çmim shumë të volitshëm, si dhe u diskutua mundësia e bashkëpunimit në implementimin e hulumtimeve specifike në sektorin e IT në Kosovë.

3. Donoret

Qeveria Norvegjeze

Gjatë tremujorit të parë dhe të dytë, mjetet e Qeverisë Norvegjeze (29,452.00€) janë shfrytëzuar për të mbuluar shpenzimet e funksionimit të zyres së STIKK. Këto mjete kanë mundur një çasje më të lehtë tek donatorët, të cilët e preferojnë të financojnë projektpropozimet e shoqatave që janë të qëndrueshme në aspektin operacional.

Programi KPEP i USAID

Në financimin e Programit KPEP të USAID-it, gjatë vitit 2010 janë realizuar 4 projekte dhe 2 të tjera që janë në implementim të siper. Detajet janë dhënë në vijim:

- a) Përfaqësimi i parë të Kosovës në Panairin më të madh botëror të Teknologjisë së Informacionit, CeBIT 2010, i cili u mbajt në Hannover, Gjermani, prej 2-6 Mars 2010.
- b) Punëtorja mbi menaxhimin e marrëdhënieve me klientë (CRM) - STIKK organizoi 2 punëtori mbi menaxhimin e marrëdhënieve me klient-CRM, në ambientet e Villa Gërmia, me datë 1 dhe 2 Prill 2010.
- c) Konferenca njëditore mbi BPO (Business Process Outsourcing), u mbajt më 14 prill, në Hotelin Grand, me pjesëmarrjen e 43 përfaqësuesve nga sektori i TIK, donatorëve dhe përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës.
- d) Skills gap analysis dhe Call Center Training - në fund të muajit shtator janë aprovuar projektet në fjalë nga Programi KPEP i USAID-it, ndërsa gjatë muajit tetor/nëntor janë nënshkruar

kontratatat, kurse implementimi do te zgjasë deri ne janar 2011 (për projektin e pare) ndërsa për projektin e dyte deri ne shtator 2011.

- e) Prezentimi publik i manualit te se drejtes pronesore intelektuale per zhvilluesit softuerik

Vlera e gjithëmbarshme e fondeve te pranuar nga KPEP gjate vitit 2010 arrin shumen prej 29,737.60€.

GTZ

Gjatë tremujorit të parë te vitit, ka përfunduar projekti i GTZ në kuadër të *Open Regional Fund for Foreign Trade Promotion/IT Component project*, i filluar në prill 2009.

Ky projekt rajonal ka përfshirë 6 shtete të rajonit: Kroacia, Maqedonia, Bosna, Serbia, Kosova dhe Shqipëria, është implementuar nga ESI Bulgaria përmes partneritetit me shoqatat e TIK të vendeve të lartpërmendura. Aktivitetet e këtij projekti janë zhvilluar në 5 fusha:

- Trajnim profesional për CMMI dhe ITMark
- Inicimi i procesit për IT Mark Basic
- Certifikimi në IT Mark Basic
- Implementimi i konsultimeve për SPI Maturity
- Certifikimi për SPI Maturity

Kompanitë pjesëmarrëse nga Kosova në këtë projekt kanë qenë Interadria dhe Komtel. Interadria ka kaluar fazën e çertifikimit, ndërsa Komtel pritet ta bëjë këtë gjate muajve ne vijim. Vlera e donacionit per STIKK ka qene 2,400.00€.

4. Staf i STIKK

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2010, janë bërë disa ndryshime në stafin e STIKK:

- a) Menaxherja e projekteve, Znj. Merita Zhubi ka dhënë dorëheqje nga vendi i saj i punes më 15 janar 2010. Arsytet kanë qenë të natyrës personale (është kthyer në Angli, ku ka jetuar paraprakisht).
- b) Më 25 Janar, pas procedurave të selektimit, janë pranuar në punë në pozitën “asistente e projekteve”, Znj. Dafina Rudi dhe Znj. Njomza Uka. Pas periudhës provuese 3 muajshe, Znj. Dafina Rudi nuk i ka përmbushë obligimet e saja në mënyrë të kënaqshme, dhe për këtë arsye iu ka ndërpre marrëdhënia e punës.
- c) Më 12 maj, STIKK publikoi konkursin për vendin e punës “Asistent i projekteve”. Pas procedurave te selektimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, komisioni ka vendosur ta pranojë në marrëdhënie të rregulltë pune, kandidatin Bardh Kadiu. Bardhi ka kryer Fakultetin e shkencave kompjuterike ne Universitetin e Shtulit ne Maqedoni, dhe tanimë ka treguar progres si në aspektin personal profesional po ashtu edhe në mbështetjen rreth progresit të shoqatës.
- d) Gjatë periudhës Korrik- Shtator, është bërë një ndryshim në stafin e STIKK: Më datën 22 Korrik 2010, STIKK angazhoi z. Korab Lufi, ne cilësinë e Praktikantit në pune praktike për një periudhe tremujore.

5. Te hyrat dhe shpenzimet

Gjatë vitit 2010, të hyrat e STIKK ishin 84,019.56€, dhe ate nga 4 burime të mjeteve: Qeveria Norvegjeze permes Crimson Capital, KPEP, IPAK dhe Anëtarët e STIKK (anëtarësia, participimi në trajnime dhe aktivitete tjera). Detajet e të hyrave janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme:

Te hyrat per periudhen janar-dhjetor 2010							
Kategoria	Crimson Cap.	KPEP - BAH	Te tjere	STIKK	IPAK	Gjithsej	
Te hyrat/donacionet							
Donacionet	20,059.22	29,737.60	3,706.90	14,073.06	7,050.00	74,626.78	
Ne mall (qiraja dhe komunaliet)	5,791.00	-			-	5,791.00	
Ne mall (pajisjet)	3,601.78						
Gjithsej te hyra/donacione	29,452.00	29,737.60	3,706.90	14,073.06	7,050.00	84,019.56	

Shpenzimet

Gjatë periudhës raportuese, shpenzimet e STIKK arritën shumën prej 85,129.37€ ose 101.32% të vleres te të hyrave. Ne kete fundvit jane mbyllur te gjitha projektet qe kane qene te aktuale gjate dy viteve te fundit. Pasqyra e shpenzimeve në detaje është e prezantuar në shtojcën 1.

Shpenzimet							
	Crimson	KPEP -	GTZ	Other	STIKK	IPAK	Total
Te ardhurat personale	12,010.14	-	-	-	14,191.03	-	26,201.17
Mjete dhe pajisje	6,075.42	1,996.95	-	-	-	1,269.73	9,342.10
Shpenzime operative	11,749.61	24,995.18	1,887.89	1,406.35	810.27	570.33	41,419.63
Shpenzimet e transportit	2,765.91	3,687.70	512.11	-	1,200.75	-	8,166.47
Gjithsej shpenzime	32,601.08	30,679.83	2,400.00	1,406.35	16,202.05	1,840.06	85,129.37
Net Surplus	(3,149.08)	(942.23)	(2,400.00)	2,300.55	(2,128.99)	5,209.94	(1,109.81)
Net balansi nga 31/12/2009	3,149.08	942.23	2,400.00	-	930.00	-	7,421.31
Gjendja e fundit 31/12/2010	-		-	2,300.55	(1,198.99)	5,209.94	6,311.50

6. Mbledhjet e Bordit

Gjate vitit 2010 u mbajtën gjithsej gjashte mbledhje të Bordit të STIKK, kater te rregullta (21 janar, 28 prill, 11 Gusht dhe 27 Tetor) dhe dy te jashtëzakonshme (8 shkurt dhe 12 maj,2010).

a) Më 21 janar 2010, në mbledhjen e tetë të rregulltë , ku janë diskutuar çështjet në vijim:

- ✓ Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Bordit, e mbajtur më 07 dhjetor 2009
- ✓ Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor
- ✓ Diskutimi dhe aprovimi i raportit vjetor
- ✓ Diskutimi dhe aprovimi i materialeve të përgatitura për mbledhjen e Kuvendit
- ✓ Delegimi i detyrave për mbledhjen e Kuvendit
- ✓ Të ndryshme

Pas diskutimeve të anëtarëve të Bordit, u morën këto vendime: të përgatiten të gjitha materialet e nevojshme për Mbledhjen e Kuvendit, si dhe u bë shpërndarja e detyrave në mesin e anëtarëve të Bordit lidhur me prezentimet dhe pikat e rendit të ditës në Mbledhjen e Kuvendit.

b) Më 08 shkurt 2010, në mbledhjen e jashtëzakonshme, me këtë rend dite:

- ✓ Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Bordit, e mbajtur më 21 janar 2010
- ✓ Diskutimi dhe përzgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarit të ri të Bordit të STIKK
- ✓ Përzgjedhja e nënshkruesit të dytë financiar (në vend të Z. Enver Doko)
- ✓ Formimi i komisioneve punuese, bazuar në planin e punës të aprovuar në Mbledhjen e Kuvendit më 28 janar 2010
- ✓ Të ndryshme

Nën të ndryshme u propozuan dhe disa pika të tjera:

- ✓ Vizita e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës për zhvillim CEDG
- ✓ Diskutimi lidhur me përtrirjen e kontratës së punës së drejtoreshës ekzekutive znj. Vjollca Çavolli.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Bordit, u morën këto vendime: në mënyre unanime u zgjodhën z. Durmishali Smani për kryetar te Bordit, ndërsa z. Driton Hapçiu, për hir të vazhdimësisë së punës u zgjodh për nënkryetar; u vendos që nënshkruesit e rinj (në vend të Enver Dokos dhe Durmishali Smanit) të jenë z. Gazmend Kajtazi, dhe z. Shkumbin Brestovci; vendoset të caktohen takimet me Ministrin Arsim Bajrami si dhe vendoset ti vazhdohet kontrata Drejtoreshës Ekzekutive me kohëzgjatje dyvjeçare; vendoset që të formohen 8 komisione dhe çdo komision punues të jete i mbikëqyrur nga një anëtar i Bordit, si në vijim:

- ✓ Legjislacioni, taksat dhe tatimet- z. Fahri Avdiu
- ✓ Sistemi arsimor dhe edukimi – z. Gazmend Kajtazi
- ✓ Telekomunikacioni – z. Visar Dobroshti

- ✓ Strategjia Kombëtare e TIK- z. Shkumbin Brestovci
- ✓ Inkubator Biznesi – z. Durmishali Smani
- ✓ Njohja ndërkombëtare –z. Driton Hapçiu
- ✓ Aplikimi i standardeve- z. Dardan Vokshi
- ✓ E-Qeverisja- z. Vjollca Çavolli

c) Më 28 prill 2010, në mbledhjen e dhjetë të rregulltë , ku janë diskutuar çështjet në vijim:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Bordit, e mbajtur më 8 shkurt 2010
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK
3. Diskutimi dhe aprovimi i MoU me Oden Ekonomike të Kosoves
4. Të ndryshme

Pas diskutimeve të anëtarëve të Bordit, tri pikat e para u aprovuan pa verejtje ndersa nën të ndryshme, u vendos që të bëhet një hulumtim me taksat doganore të artikujve të IT në Kosovë dhe të bëhet një krahasim i taksave doganore të artikujve të njëjta me kodet doganore të vendeve rajonale. Pasi të perfundohet hulumtimi doganor, të derghet të anëtarët e bordit për komente dhe pastaj të pregaditet një raport, të cilin komisioni për taksat, tatime dhe legjislacion do ta prezantojë në mbledhjen e ardhshme të bordit. Çështje tjetër e diskutuar ishte edhe problemi i arkave fiskale, ku Z. Avdiu propozoi reagimin e shoqatës përmes konferencës për shtyp dhe dokumentin duhet ta përgatis Drejtoresha ekzekutive e STIKK. Anëtarët e tjerë të Bordit, reagojnë në këtë propozim me argumentin se Drejtoresha e STIK nuk është personi adekuat që ta bëjë këtë, por duhet të jetë njëri nga anëtarët që ka njohuri më të hollësishme rreth këtij procesi. Pas përgatitjes së këtij reagimi të shkruar dhe të argumentuar, Bordi do të vendosë se a do të shkohet me reagim publik lidhur me këtë çështje.

d) Më 12 Maj 2010, në mbledhjen e jashtëzakonshme, me këtë rend dite:

1. Diskutimi dhe aprovimi i një dokumenti dhe reagimi i shoqatës në lidhje me arkat fiskale
2. Caktimi i takimeve
3. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës, u diskutua rreth hartimit të një dokumenti dhe reagimit të shoqatës rreth problemit të arkave fiskale. Pas diskutimeve të ndryshme rreth menyrës së reagimit, problemeve të shumta të cilat po shkaktohen nga arkat fiskale, problemit të cmimeve të produkteve, vështirësive për licencimin e kompanive, u vendos caktimi i takimeve me OEK, iniciimi i Tryezës së Rrumbullakët dhe hartimi i dokumentit mbështetës.

e) Më 11 Gusht 2010, në mbledhjen e dymbëdhjetë të rregullt , ku janë diskutuar çështjet në vijim:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Bordit, e mbajtur më 28 prill 2010
2. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit, e mbajtur më 12 maj 2010
3. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK
4. Diskutim rreth kërkesës për dorëheqje të anëtarit të bordit z. Fahri Avdiu
5. Diskutim për draft kodin e etikës

6. Të ndryshme

f) Më 27 Tetor 2010, në mbledhjen e trembëdhjetë të rregullt , ku janë diskutuar çështjet në vijim:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullore e Bordit, e mbajtur më 11 Gusht 2010
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK
3. Të ndryshme:
 - *Raport final i Crimson Capital*
 - *DFID*
 - *Partneriteti i mundshëm me kompanitë holandeze*
 - *Anëtarësimi i STIKK në Shoqatën e PIN-SME në Bruksel*
 - *Tryeza e rrumbullakët- Plani B për lobim dhe avokim - (STIKK- OEK-AMCHAM)*
 - *Plotësimi i procesverbalit nga mbledhje e rregullore e Bordit, 11 gusht 2010*
 - *Përvjetori i II i STIKK*

Pas diskutimeve të anëtarëve të Bordit, dy pikat e para u aprovuan me vërejtje në piken e parë, rreth informimit të anëtarëve për dorëheqjen e z. Fahri Avdiut.

Pas prezantimit të raportit tremujor nga ana e Drejtoreshës Ekzekutive, Znj. Vjollca Çavolli, u vendos që:

- ✓ Te aprovohet raporti tremujor dhe të gjitha pikat e paraqitura tek të ndryshme

7. Permbyllje

Me gjithë vonesat në implementimin e aktiviteteve të parapara me planin e punës (aprovuar në mbledhjen e Kuvendit, janar 2010) dhe pengesave gjatë implementimit të tyre, viti 2010 mund të kategorizohet si i suksesshem, për faktin se STIKK ka nisur të njihet nga ana e paleve të interesit si një partner serioz strategjik i cili përfaqëson një sektor dinamik me trend të zhvillimit. Iniciativa e STIKK mbi heqjen e taksave doganore për pajisjet e TI ka mberrijte në agjendën e vendimmarresve, dhe shpresojmë se së shpejti do të kemi një përgjigje të krenarshme. Gjatë kësaj periudhe është punuar edhe rreth nderkombetarizimit të shoqatës, krijimit të mundësive për biznes, informimit të anëtarëve mbi aktivitetet e shoqatës përmes buletinit dymujor, ofrimit të trajnimeve profesionale si dhe për rritjen e interesimit të donatoreve potencial për të investuar në fushën e TIK. Në periudhën e ardhshme, STIKK do të vazhdojë të angazhohet rreth krijimit të një ambienti më të favorshëm për kompanitë anëtare, ndërsa theks i posaçëm do të jipet edhe çështjes së avansimit të edukimit dhe trajnimit të kuadrove profesionale për tregun e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit.

**Prishtinë,
Janar, 2011**

SHTOJCA 1

STIKK							
Income Statement for period 01Jan - 31 Dec 2010							
Category	Crimson Cap.	KPEP - BAH	GTZ	Other	STIKK	IPAK	Total
Revenues/Donations							
Donations	20,059.22	29,737.60		3,706.90	14,073.06	7,050.00	74,626.78
In kind (office rent & utilities)	5,791.00	-				-	5,791.00
In kind equipment	3,601.78						
Total revenues/donations	29,452.00	29,737.60	-	3,706.90	14,073.06	7,050.00	84,019.56
Expenses							
Labor (including benefits/taxes)							
Executive Director	7,842.14	-	-	-	7,937.32	-	15,779.46
Other Staff	4,168.00	-	-	-	6,253.71	-	10,421.71
Total Labor	12,010.14	-	-	-	14,191.03	-	26,201.17
Equipment & Furniture							
Furniture	-	-	-	-	-		
Equipment	6,075.42	1,996.95	-	-		1,269.73	9,342.10
Total Equipment & Furniture	6,075.42	1,996.95	-	-	-	1,269.73	9,342.10
Operating Expenses							
Office Rent	3,875.00	-	-	-	-	-	3,875.00
Utilities & Security	1,916.00	-	-	-	-	-	1,916.00
Phone & Fax	589.00	448.22	487.81	-		268.58	1,793.61
Internet	-	-	-	-	-	-	-
Marketing & Advertising	1,822.00	4,200.50	-	1,356.35		34.80	7,413.65
Bank Services	45.50	45.00	-	-	69.50	1.50	161.50
Legal Services	-	538.15	-	-		-	538.15
Accounting Services	1,200.00	-	1,200.00			-	2,400.00
Promotional activities	-	898.19	-	-		-	898.19
Consultants fee	190.00	9,855.00	-	50.00	-	-	10,095.00
Other	2,112.11	9,010.12	200.08	-	740.77	265.45	12,328.53
Total Operating Expenses	11,749.61	24,995.18	1,887.89	1,406.35	810.27	570.33	41,419.63
Travel							
Local & Regional Travel	2,765.91	3,687.70	512.11	-	1,200.75	-	8,166.47
Total Travel	2,765.91	3,687.70	512.11	-	1,200.75	-	8,166.47
Total Expenses	32,601.08	30,679.83	2,400.00	1,406.35	16,202.05	1,840.06	85,129.37
Net Surplus	(3,149.08)	(942.23)	(2,400.00)	2,300.55	(2,128.99)	5,209.94	(1,109.81)
Net balance from 31/12/2009	3,149.08	942.23	2,400.00	-	930.00	-	7,421.31
Ending balance 31/12/2010	-	(0.00)	-	2,300.55	(1,198.99)	5,209.94	6,311.50
Cash on bank on 31/12/2010							6,254
Cash on hand on 31/12/2010							444
Total cash							6,698